

NE EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiçan, Dega në Novobërdë - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Hasan Sadiku, me proqesmbajtjen Mimoza Mehmeti, në lëndën penale kundër të akuzuarit I. I nga fsh. Llabjan, për shkak të veprës penale vjedhja e pyellit nga neni 358 par 2 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokuroris Themelore në Gjiçan, PP.II.nr. 2181/15, të datës 15.12.2015, të cilën e përfaqësonte prokurorja e shtetit Shefik Mehmeti, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dat 04.04 2016 si dhe seancave gjyqësore me 22.08.2016, 26.09.2016 dhe 31.10.2016 ndërsa më 01.11.2016 shpalli publikisht, këtë,

A K T G J Y K I M

I akuzuari I I pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati, S dhe e ëma, N e lindur i lindur më në fsh. Komuna e Novobërdes, ku edhe jeton shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i katër fëmijeve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, më parë i pa dënuar, për ndonji veprë penale, nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale,

ë s h t ë f a j t o r

Sepse me date 17.10.2015, rreth ores 11.00 min, ne fsh. Komuna së Novoberdës, në vendin e quajtur " " në pyllin e pronës private të të dëmtuarit D A nga fsh. , me qëllim vjedhje, me sharrë dore dhe me sopat i ka prerë 300 copë dynj-vishkuj të lartësisë 3-5m, në cung 10-15 cm ose 10-12 metra kub, me qka të dëmtuarit I ka shkaktuar dëm në shumë prej 350 (tre qindë e pesdhjetë) euro.

-me çka ka kryer kryer veprën penale, vjedhje e pyllit nga neni 358 para. 2 të KPRK-ës,

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 41, 45, 64, 73, të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPRK-së, të akuzuarin,

E G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 45 (dyzet e pesë) ditësh e të cilin dënim ka për ta vajtur menjë her pas plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

I akuzuari obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin në shumë prej 20 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari D. A për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën, PP.II.nr.2181/2015, të datës 15.12.2015, kundër të pandehurit I nga fsh. Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 paragrafi 2 i KPRK-së.

Prokurori e shtetit Shefik Mehmeti, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: gjatë mbajtjes së seancave gjyqësore pas dëgjimit të të dëmtuarit D. A dhe dëshmitarëve, Sh. O. S. A dhe B. B. si edhe pas leximit të kopjaës së planit e datës 21.10.2015, sikur edhe shiqimit të fotodokumentacionit 04/1-06N-171/2015 të dt.09.11.2015 me padyshim është vërtetuar se tani i akuzuari me sharrë dore dhe me sopat i ka prerë drut në pyllin privat të tani të dëmtuarit më afër të përshkruara sikur në dispozitivit të aktakuzës. Andaj i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe penalisht përgjegjës dhe ti shqiptoi një dënim meritor sipas kodit penal gjithnji duke i marrë për pazë të gjitha rrethanat sikur ato lehtësuese ashtu edhe ato rënduese.

I akuzuari I në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: Nuk ndihem fajtor për veprën penale të cilën ma vënë në barrë aktakuza, dhe në mbrojtjen e tij ka shtuar: mali im në vendin e quajtur "I" kufizohet me malin e të tani të akuzuari D. A për ndyshe shok i imi e me të cilin gjatë vitit 2015 e kemi pasur një mosmarrveshtje për shkak se unë traktorin tim pa rimorkio e kisha lënë në një livadh, e në të cilin e kisha lënë edhe sharrën e dorës, e të cilën sharrë e kanë marrë, derisa unë isha duke u shëtitur nëpër mal. Drut e prera nuk kanë qenë as në malin e tani të dëmtuarit e as në malin tim por nuk e di se drut e prera në të cilin mal kanë qenë. Prona ime në anën e djathtë kufizohet me malin e të dëmtuarit e cila një pjesë është livadh dhe një pjesë është mal. Ditën kritike papritmas në mal kanë ardhur pesë operona, dhe atë i dëmtuari D., me nipin e tij M. si dhe Sh. O. dhe Q. A të dy pylltar të APK në Novobërdë, si dhe një person tjetër.

Me qenë se i akuzuari nuk e ka pranuar fajësin gjykata, gjatë shqyrtimeve gjyqësore ka dëgjuar, të dëmtuarin D. A dëshmitarët sh. O. dhe S. A të dy roje e pyllit në APK, zjar në Novobërdë, dhe B. B.

zyrtare policore në Novobërdë, si dhe ka bërë leximin e kopjes së planit të atës 21.10.2015, si dhe shiqimin e fotodokumentacionit me nr.04/1-06N-171/2015 të datës 09.11.2015.

I dëmtuari D A në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar, jetoj në fsh. , personin të cilin sot e kam para meje e njof që nga vitet 1977 e me të cilin kemi pasur shoqëri të ngush dhe shpeshë her i kemi ndihmuar edhe njëri tjetrit. Data nuk më kujtohet por ka qen viti 2015, rastsishtë kam shkuar në malin tim të trashëguar nga babai në vendi e quajtur " " dhe ate që e kam parë në male jamë shokuar pasi që nuk kam ditur qka të veproj, jamë kthyer në shtëpi, e kam njoftuar familjen time dhe pastaj e kam njoftuar edhe policin, e cila ka ardhur në vendin e ngjarje, e kemi bër numrimin e trungjeve të prera të cilat kanë përfshirë një sipërfaqe diku prej 0.01.20.h e kanë hartuar proqesërbalin. Të nesërmen me ftesën time kanë ardhur në vendin e ngjarjes edhe pylltarët Sh O dhe S. A ku së basku e kemi takuar tani të akuzuarin Ismet, duke prerë malin, me që rast shumë jamë revoltuar dhe të njëjtit i jamë drejtuar me fjalët" duhet të vije turp për këtë dëmë" dhe ja kamë marr sharrën e dorë, e të cilë kurrë nuk ia kam kthyer. Procedurës penale kundër të akuzuarit i bashkangjitem dhekompenzimin e dëmit të shkaktuar e kërkoj.

Dëshmitari ,Sh O, ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: ditën kritike së bashku me kolegun S. A e kemi takuar tani të akuzuarin I me traktor pa rimorkio, ku në afërsi të traktorit kishte pasur dru të prera me sharrë dore e të cilën sharrë e kemi marrur si mjet me të cilin është kryer vepra penale. Me qen se sikur tani i akuzuari ashtu edhe i dëmtuari kanë pretenduar se drut e prera kanë qenë në malin e tyre, të njëjtëve ju kemi rekomanduar që ti sjellin dokumentet zyrtare-skicat apo fleta pronsore, por nuk e di se të njëjtit a i kanë sjall apo jo.

Dëshmitari S A në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: me datë 17.10 2015 rreth orës 12.35 min, më ka thirrur me telefon i dëmtuari D dhe më ka treguar se si i akuzuai ia kishte prer malin e tij. Pas parnimit të kësaj informate së bashku me kolegun e tin Sh O, ka ndalur në vendin e ngjarjes, ku e kemi takuar tani të akuzuarin I. I duke prer dru me sharrë dore dhe sopat, dhe i kemi fotografuar drut e prera. Trashësia e druve të prera ka qenë në trung 8-10cm, dhe lartësi 3-5m.

Dëshmitarja B B, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: nga kolegë jamë njoftuar se duhet të dalim në vendin e ngjarjes në fsh. , pasi që kinse një person kishte prerë dru. Për në vendin e ngjarjes jemi nisur me kolegët B F dhe J S, por për shkak të kushteve të vështira atmosferike unë nuk

kam arritur të shkoja në vendin e ngjarjes por në vandi e ngjarjes kanë shkuar kolegët, e të cilët më kanë treguar se si e kishin takuar tani të akuzuarin duke prerë dru, e i cilu të njëjtë ju kishte treguar se është duke prerë në malin e tij. Si zyrtare policore për të marrë një deklaratë nga tani i akuzuari kam shkaur edhe në shtëpinë e tij në fsh.

por nuk e kam takuar tani të akuzuarin I dhe me këtë rast djeli i tij ka deklaruar se se ne posedojmë dokumentacion pronar për malin e prerë, dhe herën e dytë e kam takuar në shtëpinë e tij tani të akuzuarin I dhe në kërkesën time që i njëjti të jap një deklaratë me shkrim lidhur me malin në të cilin e kishte prerë drut i njëjti ka refuzuar që të jap deklaratë duke thënë se "hajni nuk jep deklaratë". Dëshmitarja ka shtuar edhe këtë se për këtë rast e kam intervistuar edhe një roje të pyllit dhe i njëjti ka deklaruar se e ka parë tani të akuzuarin duke prerë dru në vendin e ngjarjes.

Nga leximi i kopjes së planit të datës 21.10.2015 qertifikatës së pronësisë, si dhe memorandumit zyrtar 04/1-06/171/2015 të datës 09.11.2015 gjykata ka konstatuar se pronarë nga 1/2 pjesë ideale të malit kontestues janë D A dhe C A. në bazë të azhurimit të datës 24.01.2014 dhe se është kërkuar vlersimi i dëmit të shkaktuar nga ana e tani të akuzuarit I I në pyllin e D A në vendin e quajtur " ".

Nga provat e shtjelluara dhe faktet e konstatuara gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ditën kritike në fsh. , në vendin e quajtur " ", në pyllin privat të dëmtuarit D A me qëllim vjedhje, me sharrë dore ka prerë 330 cop "vishkuj" të lartsisë 3-5m, të trashësisë 10-12 cm ose 10-12 metër kub, me qka e ka dëmtuar të dëmtuarin në shumë prej 350 euro, andaj edhe gjeti se ne veprimet e të akuzuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 paragrafi 2 të KPRK-se.

Gjykata vlerësoi mbrojtjen e të akuzuarit se i njëjti nuk i ka prerë drunjt në pyllin e të dëmtuarit, por gjykata gjeti se një mbrojtje e tillë është e pabazuar dhe në kundërshtim me dëshminë e të dëmtuarit D A i cili në mënyrë të detajuar ka përshkruar se si ditë më parë në pyllin e tij rastësisht i kishte vërejtur drunjt e prerë me sopatë dhe se menjëher e ka lajmruar policinë e cila të nesërme së bashku kanë dalur në vendin e ngjarjes ku e kanë takuar të akuzuarin me traktor dhe me sharrë dore. Këtë fakt e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët Sh C S A B B të cilët në mënyrë të detajuar ka treguar se si e ka parë tani të akuzuarin me traktorin e tij dhe sharrën e dorës në vendin e ngjarjes, dhe se si shenjë se e kanë takuar tani të akuzuarin në vendin e ngjarjes ia kanë marrë edhe sharrën e dorës të cilin fakt nuk e ka mohuar edhe vet i akuzuari. Se i akuzuari ta ketë kryer këtë veprë është vërtetuar edhe nga fotodokumentacioni i hartuar nga vendi i ngjarjes, i cili raport në tersi përputhet me dëshitë e të dëmtuarit si dhe të dëshmitarvetë cekur më lartë.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurit, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së. Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin, gjykata pati parasysh faktin se është prind i 4 (katër) fëmijëve, i gjendjes së varfur ekonomike, si dhe sjelljen korrekte para gjykatës se deri me tani nuk ka rënë ndeshë me ligjin. Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehuri gjykata pati parasysh rrethanat dhe mënyra e kryarjes së veprës penale pasojën e shkaktuar të veprës penale, sepse i njejt me qëllim të vjedhjes në pyllin privat të të dëmtuarit ka prerë 300 drunjë "vishkuj" me sasi prej 10-12 m.kub, andaj edhe të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, në mënyrë që i akuzuari në të ardhmen mos të kryej vepra tjera penale, dhe të ndikoj edhe tek të tjerët që të përmbahen nga kryarja e veprave penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, e në lidhje me nenin 450 parag.1 nën parag. 2.6 të KPRK-së.

Aktvendimi mbi kërkesën pasurore juridike është i bazuar në dispozitën e nenit 463 para. 1 të KPPK-ës

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i përgjithshëm.


P.nr. 2/2016, më 01.11.2016

Proqesmbajtsja
Mimoza Mehmeti,



Gjyqtari,
Hasan Sadiku

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.



REPUBLIKA KOSOVA
KËSHILLA JURIDIKE
OPJËS E VËRTETON
PRAVKA POTVRDJUJE
GJYKATA TËMELORË NË GJILAN-DEGA NOVOBËRDE
NOV. 01. 2016